



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot

Përmet më, _____.____.2024

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT PROCEDURË E HAPUR -PUNË, PROKURIM ELEKTRONIK

OBJEKTI I PROCEDURËS: Ndërtim i Kanalit Ujitës Bual, Përmet

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45232120-9 - Punime për ujitje

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **36 249 312** (tridhjetë e gjashtë milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e treqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH i detajuar si më poshtë:

Financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2024 do të jetë në vlerën **14 565 044** (katërmëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyzetë e katër) lekë pa TVSH dhe **për vitin 2025** do të jetë në vlerën **21 684 268** (njëzetë e një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Përmet** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.
- c. Formularin e ofertës sipas shtojcës 1

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26 dhe 29 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1.Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43,pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (b) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2021, 2022 dhe 2023, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor

të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet **për vitin 2023** (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore **dhe për vitin e fundit 2024 (këstet e maturuara).**

Sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe neni 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

Ose

- b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë jo më e vogël se dyfishi i fondit limit të kontratës që prokurohet.

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, **Pika 2.3.1/a** plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse **pika 2.3.1/b** duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë

të njëjtën përqindje pjesmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Akt i kolaudimit
- Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacion/faturë tatimore;
- Dhe çdo lloj dokumenti tjetër që provon realizimin me sukses të punëve;
- Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;

-Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe Prokurën e posaçme, të deklaruara në fazën e tenderimit.

-Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin nga ana e Autoritetit Kontraktor.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 40 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera e fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”* e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

NP-1 A (Punime gërmimi në tokë)

NP- 4 A (Rruge , autostrada, mbikalime,hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale)

NP- 5 A (Punime nëntokësore,ura e vepra arti)

NP- 7 B(Ujësjiellësa,gazsjiellësa,vajsjiellësa,vepra kullimi e vaditje)

NP-11 A (Ndërtim për N/stacionet,kabinat e transformatorëve, linjat e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)

NP-12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)

Për punimet speciale të ndërtimit:

NS- 1A (Punime prishje ndertimore)

NS-4 A (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese)

NS-18 A (Punime topogjeodezike)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kategorite dhe nivelet e licencave të kerkuara janë bazuar në Lidhjen 2,3 dhe 4 të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin e Rregullores Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Konkretisht:

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gërmimi në tokë	<ul style="list-style-type: none">- Gërmim toke e forte kanal (soletone + plinta te ure kanalit)- Gërmim toke e forte kanal (kanal per tubo celiku + dalje se prizave)- Gërmim toke e forte per priza + hyrje - dalje tubi- Gërmim gropa shtyllash ,toke e forte kat IV ~2.5 m,sip. Tab 1.5 m²	Kategoria A	0-20 milion lekë 581 324 leke
NP-4	Rruge , autostrada, mbikalime,heku rudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale	<ul style="list-style-type: none">- Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji, kategoria III, (trase)- Nenshtrese zhavori- Mbushje, rafshim,ngjeshje- Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km- Nenshtrese zhavori (soletone+bloqet mbajtese te urekanalit)- Mbushje, rafshim,ngjeshje (ure kanali+ure kembesore)- Nenshtrese zhavori (linja kryesore)- Struktura monolite betoni C 20/25 (bazamenti etj)- Transport dheu me auto deri 5 km- Transport materiale elektrike me kamion me vinc 5 - 10 ton deri 20 km	Kategoria A	0-20 milion lekë 5 618 737 leke

NP - 5	Punime nëntokësore, ura e vepra arti	<ul style="list-style-type: none"> - Struktura te holla monolite betoni C 16/20 (soleta e kalimit) - F V hekur betoni i zakonshem Ø 6-10mm - Struktura te holla monolite betoni C 16/20 (ure kanali) - Struktura monolite betoni C 12/15 (blloqet mbajtese) - Hidroizolim ure kanali (bashkimet) - Shtrese lluster cemento 1:2, t = 20 mm 	Kategoria A	0-20 milion lekë 508,550 leke
NP-7	Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje, naftësjellës, gazsjellës, vajsjiellës	<ul style="list-style-type: none"> - Struktura te holla monolite betoni C 12/15 (betoni I kanalit) - Prize me elem. B.A. parabolike per 100l/sek, me porte barazh - Struktura monolite betoni C 12/15 (per prizat) - Struktura monolite betoni C 12/15 (per rakordim) - Porte metalike me mekanizem ngrites me krahe (0.45x1 priza) - Porte metalike me mekanizem ngrites me krahe (pusetat) - F.V. tuba celiku φ>200 - F.V Tuba çeliku i zi (per prizat) - Struktura monolite betoni C 12/15 (hyrjet edhe daljet e tubave te celikut) - Struktura monolite betoni C 12/15 (bloqe betoni per mbeshtetjen e tubave te celikut) - Struktura monolite betoni C 12/15 (per rakordim) - Hekur betoni (zgare mbrojtese) - F+v flanaxhe shk.per tub çeliku Φ>200 - Hidroizolim koke tubi 2d bitum+1kk - Lyerje tubi antiruxhio+boje vaji (per saldimet e tubove) - F.V. tuba celiku φ>200 te pa izoluar per ujesjiellsa te jashtem (tubacioni nga vepra e marrjes deri tek tubacioni I linjes kryesore) - F.V. tuba celiku φ>200 te pa izoluar per ujesjiellsa te jashtem (tubi I thithjes L~25 m) - F.V. tuba celiku φ>200 (linja kryesore φ 350) - Struktura monolite betoni C 16/20 (puset + puseta) - F.V valvola moskthimi celiku me flanaxha ,Pn deri 25 bar,Ø 300 - 350(valvula e thithjes + tek pusetat) - F.V. saracineska gize me flanaxha, Pn deri 16 bar, φ300-350 - Hekur betoni (per bazamentin,puset etj) - F.V. flanaxha celiku cift Pn=16,φ250-300 - F.V. flanaxha celiku cift Pn=16, φ200 - Montim pompe zhytесе -Pompe centrifugale 100 kvA Q=50l/s h=38 m 	Kategoria B	21-50 milion lekë 23 073 198 lekë
NP-11	Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e	<ul style="list-style-type: none"> -F.v shtylle B/A cent.10/15/kn220/370 d1/d2 (me makineri) -Shtrese betoni c16/20 -Punime izolimi elektrik ne linja T/M 6~10 kv,me izolator mbeshtetes 6-10 kv 3 cope -Berje lozanke ne shtylle ne shtyllat me dopio izolator per faze 	Kategoria A	0-20 milion lekë 2 622 184 lekë

	energjisë elektrike.	<ul style="list-style-type: none"> -FV.Morseta me kanale paralele AL-AL 16-120 /16/120 -Aksesore flanaxha etj -F.V Percjelles ACSR -25 mm² per lidhje pajisjesh (urat) -F.V Kapikorde SY AL 25xM10 -Fv. Kabell Al-Kabell Cu 4x35 mm² izo.XLPE 0.6/1 KV -F.v kapikorde SY Al/Cu 35 mm² M12 -Fasheta plastike per fiksime kablli ne shtylle -Montim transformator shperndares deri ne 180 kvA ,20/10/6/0.4 KV -Montim ndares I jashtem TM 10KV 200-400 A -Montim sig.te jashtme TM 10 KV (bazament + fisheke 5 A) -Montim shkarkues I jashtem tip ventil TM 10 KV ,10 KA -FV. Tabela paralajmeruese -FV. Bullon St/Zn M12X40 dado/rondele suste/rondele drejte -FV.Litar celiku St/Zn Ø 12 mm (fleksibel) -F.V Elektroda tokezimi "X" 50x50x5 mm L=2 m e galvanizuar -FV.Shirit tokezimi St/Zn 40x4 ne kanale -FV.Morset univers . Shkeputes Tokez.Ø 9-16 mm -FV.Kapikorda te xinguara 95 mm² M12 -FV.Bulon St/Zn M12x40 dado /rondele suste rondele drejte -Autovinc 5 ton per ngritje e zbritjen e shtyllave ne auto 0.5 ore per shtylle -Transport Elemente betoni dhe b/a me auto deri 10 km -Transport shtylla betoni 10 ml me krah deri ne 10 m -Ndares 3P TM 12.5 Kv 200 A 16 Ka I jashtem -Siguresa TM 6/10 kv -Shkarkues Ventil TM 6-10 Kv -Transformator fuqie 10/0.4 kv 100 kva -Panel TU 1x160A + 2x63 A Jashtem -Panel komandimi pompe I jashtem 		
NP-12	Punime të inxhinierisë së mjedisit	<ul style="list-style-type: none"> - Prerje bime te vogla ø-10cm - Prerje e sistemim pemesh ø 10 - 20 cm 	Kategoria A	0-20 milion lekë 273,713 leke
NS-1	Punime për prishjen e ndërtimeve	<ul style="list-style-type: none"> - Rrafshim skarpatesh, me krahe, ne germim toke te zakonshme - Rrethim me kollona b/a + rrjete teli (paneli+ kabina+ pompa) - Germim gropa shtyllash ,toke e forte kat IV ~2.5 m,sip. Tab 1.5 m² 	Kategoria A	0-20 milion lekë 1,097,639 leke
NS-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik	<ul style="list-style-type: none"> - Shkalle metalike me hekur Ø dhe profile (per te zbritur tek vepra e marrjes) - F.V konstruksione te thjeshta metalike (bazament trafo+ndaresi+shkarkuesi+panel TU te zinkuara) - Traversa metalike per 0.4~10kv 	Kategoria A	0 – 20 milion lekë 145,498 leke

	dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese			
NS-18	Punime topogjeodezike	<p>Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji, kategoria III, (trase)</p> <p>Germim toke e forte kanal</p> <p>Rrafshim skarpatesh, me krahe, ne germim toke te zakonshme</p> <p>Germim toke e forte kanal (kanal per tubo celiku + daljes se prizave)</p> <p>F.V. tuba celiku φ>200 (linja kryesore φ 350)</p> <p>Rrethim me kollona b/a + rrjete teli (paneli+ kabina+ pompa)</p> <p>F.v shtylle B/A cent.10/15/kn220/370 d1/d2 (me makineri)</p>	Kategoria A	<p>0 – 20 milion lekë</p> <p>12 749 416 leke</p>

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes se ofertave, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Diplomë.

(Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishem gjate gjithe kohes qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas perqindjes se bashkepunimit).

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohe sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, **te perfshire ne licensen e shoqerise**, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:

- Inxhinier Ndertimi profili Infrastruktura Transport 1(nje)
- Inxhinier Ndertimi 1(nje)
- Inxhinier Topograf/Gjeodet/Marksheder 1(nje)
- Inxhinier Hidroteknik 1(nje)
- Inxhinier Gjeolog 1(nje)
- Inxhinier Mjedisi 1 (nje)
- Inxhinier Elektrik 1(nje)

- Nje (1) punonjes “pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune ”, i cili duhet te jete i certifikuar “Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen ne pune ” ne perputhje me klauzolat e ligjit nr 10327 date 18.02.2010 “ Per sigurine dhe mbrojtjen ne pune” dhe VKM NR 312 date 05.05.2010, “Per Miratimin e Rregullores per Sigurine ne Kantjer.”

Nr	NR.ANLZ	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	NJESIA	STAFI I INXHINIEREVE		
1	2	3	4			
A.KANALI DHE VEPRAT E TIJ						
1	3.90/b	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji, kategoria III, (trase)	m ³	ING.NDERTIMI TRANSPORT	ING.GJEODET	ING.GJEOLOG
2	3.88/a	Germim toke e forte kanal	m ³	ING.NDERTIMI TRANSPORT	ING.GJEODET	ING.GJEOLOG
3	3.48/b	Rrafshim skarpatesh, me krahe, ne germim toke te zakonshme	m ²	ING.NDERTIMI TRANSPORT		
4	3.2	Prerje bime te vogla ø-10cm	m ²	ING.MJEDISI		
5	3.3	Prerje e sistemim pemesh ø 10 - 20 cm	cope	ING.MJEDISI		
6	2.258	Nenshtrese zhavori	m ³	ING.NDERTIMI TRANSPORT		
7	3.241	Struktura te holla monolite betoni C 12/15 (betoni I kanalit)	m ³	ING.NDERTIMI		
8	3.656	Prize me elem. B.A. parabolike per 100l/sek, me porte barazh	cope	ING.HIDROTEKNIK		
10	3.47/1c	Mbushje, rafshim,ngjeshje	m ³	ING.NDERTIMI TRANSPORT		
11	3.242	Struktura monolite betoni C 12/15 (per prizat)	m ³	ING.NDERTIMI		
12	3.242	Struktura monolite betoni C 12/15 (per rakordim)	m ³	ING.NDERTIMI		
13	An	Porte metalike me mekanizem ngrites me krahe (0.45x1 priza)	cope	ING.NDERTIMI	ING.HIDROTEKNIK	
14	An	Porte metalike me mekanizem ngrites me krahe (pusetat)	cope	ING.NDERTIMI	ING.HIDROTEKNIK	
15	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m ³	ING.NDERTIMI TRANSPORT		
B.URE KEMBESORE+URE KANAL						
1	3.88/a	Germim toke e forte kanal (soletone + plinta te ure kanalit)	m ³	ING.NDERTIMI TRANSPORT	ING.GJEODET	ING.GJEOLOG
2	3.243/1	Struktura te holla monolite betoni C 16/20 (soleta e kalimit)	m ³	ING.NDERTIMI		

3	2.166	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6-10mm	ton	ING.NDERTIMI		
4	3.243/1	Struktura te holla monolite betoni C 16/20 (ure kanali)	m ³	ING.NDERTIMI		
5	3.242	Struktura monolite betoni C 12/15 (bllloqet mbajttese)	m ³	ING.NDERTIMI		
6	2.197	Hidroizolim ure kanali (bashkimet)	m ²	ING.NDERTIMI		
7	2.200	Shtrese lluster cemento 1:2, t = 20 mm	m ²	ING.NDERTIMI		
8	2.258	Nenshtrese zhavori (soletone+bllloqet mbajttese te urekanalit)	m ³	ING.NDERTIMI TRANSPORT	ING.GJEOLOG	
9	3.47/1c	Mbushje, rafshim,ngjeshje (ure kanali+ure kembesore)	m ³	ING.NDERTIMI TRANSPORT	ING.GJEOLOG	
		C.KALIM ME TUB CELIKU				
1	3.46/1	Germim toke e forte kanal (kanal per tubo celiku + daljes se prizave)	m ³	ING.NDERTIMI TRANSPORT	ING.GJEODET	ING.GJEOLOG
2	3.88/a	Germim toke e forte per priza + hyrje - dalje tubi	m ³	ING.NDERTIMI TRANSPORT	ING.GJEODET	ING.GJEOLOG
3	4.60/1	F.V. tuba celiku φ>200	ton	ING.HIDROTEKNIK		
4	2.493/1	F.V Tuba celiku i zi (per prizat)	kg	ING.HIDROTEKNIK		
5	3.242	Struktura monolite betoni C 12/15 (hyrjet edhe daljet e tubave te celikut)	m ³	ING.NDERTIMI		
6	3.242	Struktura monolite betoni C 12/15 (bloqe betoni per mbeshitetjen e tubave te celikut)	m ³	ING.NDERTIMI		
7	3.241	Struktura monolite betoni C 12/15 (per rakordim)	m ³	ING.NDERTIMI		
8	2.166	Hekur betoni (zgare mbrojtese)	ton	ING.NDERTIMI		
9	4.113/14	F+v flanaxhe shk.per tub celiku Φ>200	cope	ING.HIDROTEKNIK		
10	2.197	Hidroizolim koke tubi 2d bitum+1kk	m ²	ING.NDERTIMI		
11	2.401	Lyerje tubi antiruxhio+boje vaji (per saldimet e tubove)	m ²	ING.NDERTIMI		
		D.VEPRA E MARRJES + +PUSETA+TUBACIONI I DERGIMIT (LINJA KRYESORE)				
2	4.60	F.V. tuba celiku φ>200 te pa izoluar per ujesjellsa te jashtem (tubacioni nga veptra e marrjes deri tek tubacioni I linjes kryesore)	Ton	ING.HIDROTEKNIK		

3	4.60	F.V. tuba celiku $\varphi > 200$ te pa izoluar per ujesjellsa te jashtem (tubi I thithjes L~25 m)	Ton	ING.HIDROTEKNIK		
4	4.60/1	F.V. tuba celiku $\varphi > 200$ (linja kryesore φ 350)	ton	ING.HIDROTEKNIK		
5	2.258	Nenshtrese zhavori (linja kryesore)	m3	ING.NDERTIMI TRANSPORT		
6	3.47/1c	Mbushje, rafshim,ngjeshje	m3	ING.NDERTIMI TRANSPORT		
7	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25 (bazamenti etj)	m3	ING.NDERTIMI		
8	3.243	Struktura monolite betoni C 16/20 (puset + puseta)	m3	ING.NDERTIMI		
9	4.128/8	F.V valvola moskthimi celiku me flanaxha ,Pn deri 25 bar, \varnothing 300 - 350(valvula e thithjes + tek pusetat)	cope	ING.HIDROTEKNIK		
10	4.123/9	F.V. saracineska gize me flanaxha, Pn deri 16 bar, φ 300-350	cope	ING.HIDROTEKNIK		
11	4.4	Shkalle metalike me hekur \varnothing dhe profile (per te zbritur tek vepra e marrjes)	Ton	ING.NDERTIMI		
12	2.166	Hekur betoni (per bazamentin,puset etj)	ton	ING.NDERTIMI		
13	3.837	Rrethim me kollona b/a + rrjete teli (paneli+ kabina+ pompa)	m2	ING.NDERTIMI	ING.GJEODET	
14	4.113/10	F.V. flanaxha celiku cift Pn÷16, φ 250-300	çift	ING.HIDROTEKNIK		
15	4.113/8	F.V. flanaxha celiku cift Pn÷16, φ 200	çift	ING.HIDROTEKNIK		
		E.Kabina elementet elektrike				
		E-1 Punime teknologjike dhe montimi				
		E-1-1 Shtylla				
1	Mk-1	F.v shtylle B/A cent.10/15/kn220/370 d1/d2 (me makineri)	cope	ING.ELEKTRIK	ING.NDERTIMI	ING.GJEODET
2	3.498/b	Germim gropa shtyllash ,toke e forte kat IV ~2.5 m,sip. Tab 1.5 m ²	m ³	ING.NDERTIMI TRANSPORT		
3	3.243	Shtrese betoni c16/20	m ³	ING.NDERTIMI		
		E-1-2 Aksesore shtylle				
1	4.3	F.V konstruksione te thjeshta metalike (bazament trafo+ndaresi+shkarkuesi+panel TU te zinkuara)	ton	ING.ELEKTRIK	ING.NDERTIMI	
2	3.511	Traversa metalike per 0.4~10kv	ton	ING.ELEKTRIK	ING.NDERTIMI	
4	3.569	Punime izolimi elektrik ne linja T/M 6~10 kv,me izolator mbeshtetes 6-10 kv 3 cope	shtylle	ING.ELEKTRIK		
5	MK-32/62.1	Berje lozanke ne shtylle ne shtyllat me dopio izolator per faze	shtylle	ING.ELEKTRIK		

6	MK-70	FV.Morseta me kanale paralele AL-AL 16-120 /16/120	cope	ING.ELEKTRIK		
7	2.536	F.V tuba çeliku Ø ~ 200mm	kg	ING.ELEKTRIK		
8	An	Aksesore flanaxha etj	set	ING.ELEKTRIK		
		E-1-3 Ura TM 10 KV dhe aksesoret e saj				
1	4.150/8	F.V Percjelles ACSR -25 mm ² per lidhje pajisjesh (urat)	ml	ING.ELEKTRIK		
2	L6-106	F.V Kapikorde SY AL 25xM10	cope	ING.ELEKTRIK		
		E-1-4 Ura TU 0.6/1 KV dhe aksesoret e saj				
1	L6-73	Fv. Kabell Al-Kabell Cu 4x35 mm ² izo.XLPE 0.6/1 KV	ml	ING.ELEKTRIK		
2	L6-107	F.v kapikorde SY Al/Cu 35 mm ² M12	cope	ING.ELEKTRIK		
3	An	Fasheta plastike per fiksime kablli ne shtylle	cope	ING.ELEKTRIK		
		E-1-5 Montim makineri pajisje				
1	4.02-M	Montim transformator shperndares deri ne 180 kvA ,20/10/6/0.4 KV	cope	ING.ELEKTRIK	ING.NDERTIMI	
2	4.10-M	Montim ndares I jashtem TM 10KV 200-400 A	cope	ING.ELEKTRIK	ING.NDERTIMI	
3	4.155/3	Montim sig.te jashtme TM 10 KV (bazament + fisheke 5 A)	cope	ING.ELEKTRIK	ING.NDERTIMI	
4	4.09-M	Montim shkarkues I jashtem tip ventil TM 10 KV ,10 KA	cope	ING.ELEKTRIK	ING.NDERTIMI	
5	3.614	FV. Tabela paralajmeruese	cope	ING.ELEKTRIK	ING.NDERTIMI	
6	4.06-M	Montim pompe zhytese	cope	ING.HIDROTEKNIK	ING.ELEKTRIK	ING.NDERTIMI
7	An	FV. Bullon St/Zn M12X40 dado/rondele suste/rondele drejte	cope	ING.ELEKTRIK		
		E-1-6 Tokezimi				
1	An.produkte	FV.Litar celiku St/Zn Ø 12 mm (fleksibel)	kg	ING.ELEKTRIK		
2	2.497	F.V Elektroda tokezimi "X" 50x50x5 mm L=2 m e galvanizuar	cope	ING.ELEKTRIK		
3	3.629	FV.Shirit tokezimi St/Zn 40x4 ne kanale	ton	ING.ELEKTRIK		
4	MK-70	FV.Morset univers . Shkeputes Tokez.Ø 9-16 mm	cope	ING.ELEKTRIK		
5	L6-107	FV.Kapikorda te xinguara 95 mm ² M12	cope	ING.ELEKTRIK		
6	An	FV.Bulon St/Zn M12x40 dado /rondele suste rondele drejte	cope	ING.ELEKTRIK		
		E-1-7 Transporti				
1	An	Autovinc 5 ton per ngritje e zbritjen e shtyllave ne auto 0.5 ore per shtylle	ore	ING.NDERTIMI TRANSPORT		
2	3.722	Transport Elemente betoni dhe b/a me auto deri 10 km	ton	ING.NDERTIMI TRANSPORT		
3	4.173	Transport shtylla betoni 10 ml me krah deri ne 10 m	cope	ING.NDERTIMI TRANSPORT		

4	3.158/5a	Transport dhe me auto deri 5 km	m ³	ING.NDERTIMI TRANSPORT		
5	4.176	Transport materiale elektrike me kamion me vinc 5 - 10 ton deri 20 km	ton	ING.NDERTIMI TRANSPORT		
		E-2 MAKINERI PAJISJE				
1	20001156	Ndares 3P TM 12.5 Kv 200 A 16 Ka I jashtem	cope	ING.ELEKTRIK		
2	20001681	Siguresa TM 6/10 kv	komplet	ING.ELEKTRIK		
3	20001910	Shkarkues Ventil TM 6-10 Kv	cope	ING.ELEKTRIK		
4	An.produkte	Transformator fuqie 10/0.4 kv 100 kva	cope	ING.ELEKTRIK		
5	2.544	Panel TU 1x160A + 2x63 A Jashtem	cope	ING.ELEKTRIK		
6	An	Pompe centrifugale 100 kvA Q=50l/s h=38 m	cope	ING.ELEKTRIK	ING.HIDROTEKNIK	
7	An	Panel komandimi pompe I jashtem	cope	ING.ELEKTRIK		

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri dhe formimi profesional i inxhinierëve që përbëjnë stafin kryesor teknik, është përcaktuar duke u nisur nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Kjo kërkesë është përcaktuar pas analizimit që i është bërë preventivit të punimeve (nga ku përcaktohet edhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në licencën profesionale të shoqërisë. Duke parë dhe marrë në konsideratë kompleksitetin e punimeve që do të realizohen, referuar këtu projekt-preventivit të zbatimit, është e domosdoshme që çdo ofertues të ketë pjesë të stafit të tij, inxhinierët e kërkuar në këtë pikë, të cilët në bashkëpunim me njëritjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Referuar preventivit të punimeve, si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar NP-1, NS-1 dhe NS-4, është e nevojshme prezenca e drejtuesit teknik me formim **inxhinier ndërtimi profili infrastrukture - transport.**

Referuar preventivit të punimeve, si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar NP-1 dhe NP- 5 është e nevojshme prezenca e drejtuesit teknik me formim **inxhinier gjeolog.**

Referuar preventivit të punimeve, si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar NP-4 është e nevojshme prezenca e drejtuesit teknik me formim **inxhinier ndërtimi.**

Referuar preventivit të punimeve, si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar NP-7 është e nevojshme prezenca e drejtuesit teknik me formim **inxhinier hidroteknik.**

Referuar preventivit të punimeve, si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar NP-11 është e nevojshme prezenca e drejtuesit teknik me formim **inxhinier elektrik.**

Referuar preventivit të punimeve, si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar NP-12 është e nevojshme prezenca e drejtuesit teknik me formim **inxhinier mjedisi**.

Referuar preventivit të punimeve, si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar NS-18, është e nevojshme prezenca e drejtuesit teknik me formim inxhinier **topograf/gjeodet/markshajder**.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët Ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për mbarëvajtjen, ndërhyrjen, parandalimin dhe evitimin e situatave apo problematikave lidhur me rreziqet, sigurinë dhe shëndetin në punë, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë mbështetet edhe në dispozitat e ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, VKM nr.108, datë 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë. Në dispozitat e akteve të sipërcituara, ndër të tjera parashikohet se: punëdhënësi merr masa për të ulur, sa më shumë të jetë e mundur, kërcënimet për sigurinë dhe shëndetin në punë të punëmarrësve e të personave të tjerë të pranishëm; organizon dhe siguron evakuimin e shpëtimit e punëmarrësit në rast ngjarjesh ose aksidentesh të papritura, që kërcënojnë sigurinë dhe shëndetin e tyre; punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës; çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Pra, në dispozitat e akteve të mësipërme, përcaktohen kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik, emergjencë apo të papritura në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës, i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës, duke patur në fokus primar jetën dhe shëndetin e punonjësve të angazhuar me zbatimin e punimeve.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **30 (tridhjetë) punonjës** te pasqyruar në listëpagesen e muajit te fundit. Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve muajin e fundit.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike pikat e kriterit 2.3.4 duhet te plotesohen nga secili anëtar i bashkimit, **në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje**).

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht, në përcaktimin e numrit të punonjësve që duhet të ketë shoqëria ofertuese, janë analizuar dhe janë marrë në konsideratë volumet, orët e punës, zërat, kategoritë dhe kompleksiteti i punimeve, kualifikimi i punonjësve (ku përfshihet stafit organizativ, administrativ, tekniko-inxhinierik dhe ai mbështetës), grafiku i punimeve dhe shpërndarja e kantierit etj. Vendosja e këtij kriteri është teknikisht i argumentuar, pasi i përgjigjet përmasave të kontratës që prokurohet si për nga fondi limit, kohështirja, por edhe për nga natyra e punimeve duke marrë në analizë manualin teknik të punimeve të ndërtimit në fuqi.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje minimalisht muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, tregon besueshmërinë e nevojshme për autoritetin kontraktor lidhur me përmbushjen e kontratës nga OE. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të Operatorit Ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është detyrim i punëdhënësit sipas parashikimeve të legjisllacionit të fushës dhe Kodit të Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarëve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat e kualifikimit, përveç besueshmërisë së Operatorëve Ekonomikë, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, dhe njëkohësisht është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës së punonjësve.

